

Çfarë ka të re në Udhëzuesin e PRE-s (dhe si ta shfrytëzojmë atë sa më shumë)

Janez Šušteršič

Ekspert bashkëpunëtor i CEF

Shtator 2020



Risitë në Udhëzuesin e PRE-së

- 1) Lidhja e masave të reformës strukturore (RS) me rimëkëmbjen ekonomike
- 2) Përfshirja e PRE-ve në kornizën e re strategjike të BE-së
- 3) Lidhje më të forta me IPA-n dhe procesin e anëtarësimit në BE
- 4) Kostoja e RS-së dhe implikimet fiskale të COVID-it
- 5) Një seksion i ri mbi Cilësinë e Financave Publike



1. Lidhja e masave të RS-së me rimëkëmbjen

Citimet më të rëndësishme nga Udhëzuesi

PRE-të do të duhet të fokusohen në rimëkëmbjen pas Covid-19, duke integruar në të njëjtën kohë reformat afatmesme që e bëjnë këtë rimëkëmbje të qëndrueshme dhe që krijojnë qëndrueshmëri ekonomike [...] Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet masave të rimëkëmbjes pas Covid 19.

*PRE është një program që përsëritet [...] aktivitetet e përfshira në PRE 2021-2023 duhet të jenë të njëjta me ato të përfshira në PRE 2020-2022 [...] Sidoqoftë, **disa reforma duhet të ri-prioritizohen për të mbështetur në mënyrën më adekuate rimëkëmbjen nga kriza e Covid-19.** [...] Si rregull, masat duhet të ndërpriten vetëm nëse [...] **nuk konsiderohen më si prioritet për qeverinë, veçanërisht në kontekstin e krizës Covid-19.***

*Duke raportuar edhe për zbatimin e masave të menjëhershme afatshkurtra për të zbutur krizën e Covid-19 në vitin 2020, **reformat strukturore për 2021-2023 duhet përsëri të fokusohen në masat që mbështesin zhvillimin ekonomik afatmesëm të vendit, të përshtatur për kontekstin e rimëkëmbjes nga kriza.***

Çelësi për futjen në zbatim të masave të reja është një analizë e shëndoshë e pengesave të shkaktuara nga COVID-i

*Ky seksion [mbi **pengesat** për konkurrueshmërinë dhe rritjen [ekonomike] gjithëpërfshirëse] së pari do të ofrojë një pasqyrë koncize të pengesave kryesore strukturore për konkurrueshmërinë dhe rritjen [ekonomike] gjithëpërfshirëse në nivel vendi të rishikuara në dritën e ndikimit të krizës Covid-19.*

*Ai duhet të azhurnojë analizën nga programi i mëparshëm [...] e po ashtu **të identifikojë ndonjë pengesë të re që mund të jenë shfaqur, sidomos në kontekstin e krizës Covid-19**.*

*Bazuar në këtë analizë, ky seksion duhet pastaj të **identifikojë 15-20 masa të reformës [...] për të adresuar pengesat më të rëndësishme strukturore dhe në këtë mënyrë për të mbështetur rimëkëmbjen pas-Covid-19.***

Shembuj të ri-prioritizimit të mundshëm

Si referohet rimëkëmbja në përshkrimet e fushave të politikave

Arsimi dhe aftësitë
(shkathtësitë)

*Referencë specifike duhet t'i bëhet edhe sigurimit të aftësive digjitale përmes trajnimit përkatës të mësimeve dhe përmes **arsimit digjital**.*

Punësimi dhe tregjet
e punës

*Në kontekstin e pandemisë Covid-19, kjo pjesë duhet të informojë edhe mbi **skemat e punës afatshkurtër** që kanë filluar të aplikohen për të zbutur ndikimin e pandemisë [...]*

Mbrojtja dhe
përfshirja sociale,
**përfshirë kujdesin
shëndetësor**

*Kjo pjesë do të mbulojë politikat publike për modernizimin sistemeve e mbrojtjes sociale [...] nxitjen e përfshirjes sociale, promovimin e mundësive të barabarta dhe adresimin e pabarazive dhe varfërisë, **veçanërisht duke marrë parasysh ndikimin e krizës Covid-19**.*

*Kjo pjesë duhet të jap një vlerësim dhe të përfshijë masat përkatëse të reformës në lidhje me **universalitetin** e sigurimit shëndetësor, dhe **qasshmërinë, mjaftueshmërinë** dhe **përbalueshmërinë** e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, si dhe **qëndrueshmërinë** e financimit të saj.*



Përmbledhje

Reformat mund të përshtaten, ose mund të fillohen reforma të reja, për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike, por nuk duhet të përfshihen masa të pastra të rimëkëmbjes që nuk kanë "elementin e reformës".

Një mënyrë e mirë për të kombinuar reformat me rimëkëmbjen ekonomike është që:

- të analizohet cilat pengesa (për aftësinë konkurruese dhe rritjen [ekonomike] përfshirëse) janë shfaqur ose janë bërë më të forta për shkak të krizës së COVID dhe recesionit
- të shikohet se si këto pengesa të identifikuar rishtazi mund të adresohen duke përshtatur reformat ekzistuese strukturore ose me reforma të reja që zëvendësojnë ato të vjetrat

Sigurisht, mund të fillohet me aplikimin e reformave që adresojnë rimëkëmbjen në çdo fushë të politikave, jo vetëm në tri fushat në të cilat Udhëzuesi përmend disa shembuj (siç tregohet më lartë).

Përshkrimet e fushave të politikave nuk janë urdhëruese - ato janë një meny nga e cila shteti bën përzgjedhjen bazuar në prioritetet dhe pengesat kryesore të tij.

2. Lidhja me kornizën strategjike të BE-së

Citimet më të rëndësishme nga Udhëzuesi

*PRE-të do të duhet të fokusohen në rimëkëmbjen pas Covid-19, duke integruar në të njëjtën kohë **reformat afatmesme** që e bëjnë këtë rimëkëmbje të qëndrueshme dhe që krijojnë qëndrueshmëri ekonomike **në përputhje me prioritetet e tranzicionit të gjelbër, digjital dhe të drejtë të BE-së.***

*Reformat strukturore [...] duhet të harmonizohen sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë progresive me strategjinë e zhvillimit përfshirës të BE-së nga Marrëveshja e Gjelbër **duke synuar një ekonomi me burime efikase, të shkarbonizuar dhe konkurruese.***

*Nëse është e aplikueshme, tregoni qartë [...] se si [...] masa e reformës do të kontribuojë në zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe/ose në **arritjen e Objektivave të Kombeve të Bashkuara të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).***

*Masat e reformës [...] mund të ndihmojnë në drejtimin e politikave kombëtare ekonomike dhe të punësimit drejt arritjes së [...] OZHQ-ve dhe drejt zbatimit të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane përmes **monitorimit të progresit** dhe duke siguruar **koordinim më të ngushtë** të përpjekjeve kombëtare. [...] bazuar në mënyrë ideale në tregues që janë në përputhje me **Grupin e treguesve të Eurostat për OZHQ të BE-së.***

Shembuj të ri-prioritizimit të mundshëm

Si reflektohet rimëkëmbja në përshkrimet e fushave të politikave

Reforma e tregut të energjisë dhe transportit

Masat e reformës [...] mund të fokusohen në furnizimin me **energji të pastër, të përballueshme dhe të sigurt** dhe në ndërtimin dhe rinovimin në mënyrë **efikase sa i përket energjisë dhe burimeve**, duke zhbllokuar potencialet e **energjisë së ripërtërishme** dhe **zvogëlimin e ndikimit në mjedis dhe në shëndetin** e sektorëve të energjisë dhe transportit ..

Bujqësia, industria dhe shërbimet

Masat e reformës [...] mund të fokusohen në **prodhim dhe konsum të qëndrueshëm** si dhe **shkarbonizim** dhe modernizim të industrive me energji intensive. Ato gjithashtu mund të promovojnë aplikimin e **modelit ciklik në modelet e biznesit**, sa i përket përdorimit të burimeve. Masat në bujqësi mund të synojnë zhvillimin e më shumë **sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit** me ndikim neutral ose pozitiv në mjedis.

Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni dhe

Masat në lidhje me **transformimin digjital** në përputhje me **prioritetet** e Komisionit Evropian po ashtu do të përfshihen në këtë nën-seksion, por mund të përfshihen edhe në fusha të tjera.



Si tu jepet kuptim prioriteteve të reja Marrëveshja e Gjelbër dhe Tranzicioni i Drejtë

Shpjegime të dobishme në Udhëzues rreth Marrëveshjes së Gjelbër:

RS [...] mbështet një model të rritjes ekonomike i cili është më efikas në burime, emeton më pak karbon dhe është më rezistues ndaj çështjeve mjedisore dhe shëndetësore.

[...] përfshirja progresive e qëndrueshmërisë mjedisore dhe klimatike në të gjitha reformat e rëndësishme.

Tranzicioni i drejtë ka të bëjë me ndihmën për rajonet, industrinë dhe punëtorët e prekur nga ‘tranzicioni i gjelbër’.

Burime të dobishme (përmbledhje dhe komunikim i KE-së):

https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en#actions

<https://eur-lex.europa.eu/legal->

[content/EN/TXT/?qid=1576150542719&uri=COM%3A2019%3A640%3AFIN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1576150542719&uri=COM%3A2019%3A640%3AFIN)



Si tu jepni kuptim prioriteteve të reja

Strategjia Digjitale e BE-së

Strategjia digjitale e BE-së – edhe një nga 6 prioritetet e Komisionit të ri

Fushat e ndërlidhura me politikat e PRE-së:

Energjia dhe transporti - Sistemet inteligjente të transportit.

Mjedisi i biznesit - qeverisja elektronike, tregtia elektronike, siguria, standardet.

RDI dhe transformimi digjital - Inovacioni i TIK-së dhe IA-së, brezi i gjerë.

Integrimi ekonomik - standardet, interoperabiliteti.

Shoqërore - Ndarja/përfshirja digjitale, shëndetësia elektronike, shërbimet sociale elektronike.

Aftësitë digjitale të rëndësishme për disa fusha (biznesi, RDI, arsimi, punësimi, shoqërore).

Burime të dobishme (përmbledhje dhe komunikim i KE-së):

https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/europe-fit-digital-age_en

https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/communication-shaping-europes-digital-future-feb2020_en_4.pdf



Treguesit më të rëndësishëm të OZHQ-ve për PRE

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/sdi/indicators>

<https://www.sgi-network.org/2019/>

Fusha e politikës së PRE-së	Treguesit që lidhen me OZHQ-të specifike
Energjia, Transporti	OZHQ 7 (e përballueshme dhe energji e pastër) OZHQ 9 (Industria, inovacioni dhe infrastruktura) - transporti
Politikat sektoriale	OZHQ 12 (Konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm) OZHQ 2 (Zhdukja e varfërisë) - bujqësia, mjedisi
Mjedisi i biznesit	OZHQ 16 (Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta)
RDI, digjitale	OZHQ 9 (Industria, inovacioni dhe infrastruktura) - inovacioni
Integrimi ekonomik	/
Arsimi	OZHQ 5 (arsimi cilësor)
Punësimi	OZHQ 8 (Puna e denjë dhe rritja ekonomike)
Shoqërore, shëndetësore	OZHQ 10 (Zvogëlimi i pabarazisë), OZHQ 1 (Zhdukja e varfërisë), OZHQ 5 (Barazia Gjinore), OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie)



Përmbledhje

Nuk ka asnjë konflikt në mes të objektivit të PRE-së (konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse) dhe kornizës së re strategjike evropiane:

- Marrëveshja e Gjelbër është një strategji e rritjes, e jo vetëm program mjedisor
- Transformimi digjital tashmë është pjesë e PRE-së, por mund të jetë shumë më i gjerë
- OZHQ-të fokusohen kryesisht në gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e rritjes [ekonomike]

Kështu që disa masa ekzistuese të PRE-së tashmë mund të jenë në përputhje me këtë kornizë të re strategjike, ose mund të përshtaten lehtësisht me të.

Nuk ka ndonjë detyrim për të harmonizuar menjëherë të gjitha masat e PRE-së me kornizën e re strategjike të BE-së – ajo që pritet është një evolucion gradual i masave/PRE-ve në këtë drejtim.

3. Lidhje më e fortë me integrimin në BE

Citimet më të rëndësishme nga Udhëzuesi

*Përfshirja e **ngushtë** e **koordinatorit kombëtar të IPA-s** (KKIPA) është thelbësore për të forcuar lidhjen në mes të prioriteteve të reformës së PRE-së dhe programimit IPA.*

*Prioritetet e reformës strukturore duhet në veçanti të **kontribuojnë në përmbushjen e kriterëve ekonomike për anëtarësim në BE.***

Kur është e nevojshme, shpjegoni shkurtimisht mënyrën se si masa e mbështet përmbushjen e kriterëve ekonomike për anëtarësim në BE.

Koordinimi i PRE-së, IPA-s, integrimin në BE

Përfshini KKIPA-të

- Kostimi - kontrolloni shumën dhe realizimin e fondeve të planifikuara nga IPA.
- Koordinoni planifikimin e masave të PRE-së me programimin e IPA-s.
- Sigurohuni që të Dhënat e Veprimit për IPA-n të përfshijnë projekte të cilat janë të harmonizuara me masat ekzistuese ose të planifikuara të PRE-së.
- Duhet të dini se konsistenca me PRE dhe në Udhëzuesin e Politikave Specifike të Vendit është një prej kriterëve për vlerësimin e rëndësisë së dokumenteve të programit të IPA-s.

Përfshini ministrinë/ koordinatorin e integritit evropian

- Koordinoni përparësitë e PRE-së dhe pjesën e politikës së planit për miratimin e Acquis (PKMA) ose dokumentit ekuivalent
- Reflektoni dhe referojuni masave të PRE-së në prioritetet e PKMA-së në kuptimin e masave kryesore për të përmbushur kriteret ekonomike për anëtarësim



4. Kostimi dhe implikimet fiskale

Udhëzime për trajtimin e rreziqeve dhe pasigurisë

- ❖ ***Pasiguritë dhe supozimet në lidhje me koston dhe vlerësimet e financimit duhet të shpjegohen.***
- ❖ ***Vetëm fondet që tashmë janë siguruar duhet të planifikohen dhe duhet të shmangët përdorimi i kategorisë 'të përcaktohet'.***
- ❖ ***Për masat që kërkojnë fonde të konsiderueshme ose kostot e të cilave janë shumë të pasigurta, duhet të zhvillohet një skenar i kontingjencës me një tregues se cilat aktivitete do të zbatohen si prioritet në rast se nuk do të jenë në dispozicion të gjitha fondet e planifikuara.***
- ❖ ***Për masat të cilat nuk rezultojnë menjëherë në shpenzime direkte (p.sh.: garancitë e kredisë ose zvogëlimet e tatimeve dhe tarifave), detyrimet e paparashikuara (kontingjente) pasuese ose rëniet e të hyrave, po ashtu duhet të specifikohen në këtë pjesë.***

Raportimi mbi implikimet fiskale të krizës COVID

Ndikimi i vlerësuar fiskal i krizës Covid 19 në vitin 2020?	Për shkak të masave diskrecionare të një hershme (në % të BPV)	Për shkak të masave të mëtejshme diskrecionare (në % të BPV-së)	Për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik (në % të BPV-së)
Në shpenzimin e buxhetit			
Në të hyrat në buxhet			
Ndiki i përgjithshëm në buxhet			
Në borxhin publik			
Në detyrimet e paparashikuara			

Jepni informacione specifike për detyrimet e paparashikuara të shkaktuara si pjesë masave të reagimit ndaj Covid-19, siç janë skemat e garantimit të kredisë.

Koment

Qëllimi i tabelës raportuese është të mbështesë një vlerësim të qëndrueshmërisë së financave publike në periudhën afatmesme.

Logjika prapa kësaj tablele është:

- Shpenzimet që lidhen rreptësisht me masat ndaj COVID pritet që të mos vazhdojnë pasi të futet nën kontroll kriza shëndetësore
- Çdo rritje tjetër e shpenzimeve mund të dëmtojë pozitën fiskale afatmesme.
- Të hyrat e humbura për shkak të rënies së BPV-së do të normalizohen pas rimëkëmbjes

Ju keni të drejtë të përshtatni/ thjeshtoni formatin e tabelës, por ajo duhet të mbështesë vlerësimin e gjendjes fiskale përgjatë këtyre linjave.

5. Cilësia e financave publike

Ky seksion i ri (4.8) duhet të raportojë për:

- Ndryshimet e zbatuara dhe planifikuara në përbërjen e **shpenzimeve publike** për të përmirësuar **përshtatshmërinë e saj për zhvillim dhe kontributin në përfshirjen sociale** (p.sh. pjesa e shpenzimeve kapitale, pjesa e arsimit dhe shpenzimeve shëndetësore - Tabela 3 në Aneks).
- reformat kryesore në lidhje me shfrytëzimin efikas të resurseve në sektorin publik.
- masat për të përmirësuar strukturën dhe efikasitetin e të hyrave, p.sh. hapat për të **adresuar tatimin me efekte të mëdha çrregulluese**, siç është barra e lartë fiskale mbi punëtorët **që pengon krijimin e vendeve të punës dhe nxit informalitetin**
- Kur është e përshtatshme, referojuni **efekteve rishpërndarëse të tatimit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të sigurimeve shoqërore** kundrejt kontributeve.

Teksti i nënvizuar thekson nevojën për bashkëpunim në mes të MF-së dhe koordinatorit të RS-së në hartimin e kësaj pjese.



Diskutim nga të pranishmit

- ❖ Si është duke menduar ministria juaj e linjës për masat tuaja në dritën e:
 - recesionit ekonomik të shkaktuar nga COVID
 - kornizës së re strategjike të BE-së
- ❖ Çfarë po bën ministria juaj e linjës për të adresuar Udhëzuesin e Politikave Specifike për Vendin?
- ❖ Cila do të jetë gjëja më sfiduese në Udhëzuesin e ri të PRE-së për ministrinë tuaj të linjës?
- ❖ Koordinatorët si do të:
 - **Drejtojnë procesin e ri-prioritizimit** të masave në dritën e recesionit dhe të kornizës së re strategjike?
 - Sigurojnë që **Udhëzuesi i politikave specifike për vendin** adresohet nga ministrinë përkatëse dhe qeveria?
 - Përfshijnë dhe **bashkëpunojnë me KKIPA-t dhe Ministrinë e Integritimit Evropian**?
 - Kontribuojnë në **ndërlidhjen e kornizës fiskale** me reformat e planifikuara strukturore?